

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“MEBASA - ADE” shpk**  
**(Ortak i vetëm)**

Në këtë statut

-“Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;

-“Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**KREUI**

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot me date 23.02.2018 me cilësinë e “ortakut themelues “ :

**MEMET SALAHI, i biri i Adem-it i dt. 06.02.1971, lindur ne Zherovjan, Maqedoni dhe banues ne Bogovine, rruga 101 BB, Bogovine,Tetove, Maqedoni,** shtetas Maqedonas, madhor me zotësi juridike dhe zotësi për te vepruar, identifikuar sipas ligjit nëpërmjet pasaportës Nr. K0044255 me Nr. Personal 0602971470003 lëshuar me date 03.01.2017 e vlefshme deri me date 02.01.2027, lëshuar nga MPB-Tetove, Maqedoni.

me vullnet të lire e të plote, mbështetur :

Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “, i ndryshuar, ne legjislacionin “ Për regjistrimin e biznesit ”, ne atë Doganor, Fiskal e Tatimor, etj.. dhe jo vetëm, themeloj një Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emërtimin “ **MEBASA - ADE** “ shpk, e cila është person juridik i se drejtës shqiptare, themelohet nga një ortak i vetëm, (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “ **MEBASA - ADE** “ shpk (ortak i vetëm) është një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e themeluar nga **MEMET SALAHI**, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.



Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

### Neni 3

#### **Selia, Adresa e Faqes së Internetit (nëse ka) dhe Adresa Elektronike (nëse ka)**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Lagja 13 , Shkallnur, Plepa, Durrës, Shqipëri**

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :

**abe.mebasa@gmail.com**

Shoqëria mund te ndryshoje selinë e saj, te hape zyra përfaqësie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Ortakut te Vetëm.

### Neni 4

#### **Objekti i veprimtarisë**


Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te jete ;

Veprimtari ne fushën e ndërtimit, ndërtime civile, publike, industriale, rikonstruksione, izolime termike dhe akustike, ndërtime banesash, konstruksione metalike, struktura te aluminit dhe çelikut, ura dhe vepra te tjera. Kryerjen e projekteve, prodhimit, punimeve inxhinierike dhe zbatimin e punimeve civile. Tregtimi me shumice e pakice, import-eksport te artikujve te ndryshëm industriale, lende te para ,materiale ndërtimi, mobileri dhe aksesore te ndryshëm , materiale termoizoluese dhe izolimi akustik, paneleve termoizoluese, materiale për riparim fasadash dhe lysterje objektesh, makineri e pjese këmbimi te te gjitha llojeve, paisje elektrike, paisje kompjuterike, hidrosanitare, duralumini, prodhim druri, pajisje elektroshtepiake dhe aksesoret e tyre, te ashensorëve dhe aksesoret e tyre, pajisje elektrike civile dhe industriale. Pjesëmarrje ne tendera ne sektorin publik dhe privat, lidhje e kontratave publike e private ne fushën e ndërtimit, energjisë diellore, energjisë elektrike, sistemeve termoizoluese karburanteve, ndërtim. Shërbime shitje ,blerje , dhënie me qira lidhur me pasuritë e paluajtshme, *si dhe çdo veprimtari tjetër tregtare qe nuk ndalohet me ligj.*

### Neni 5

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.





**KREU II**  
**KAPITALI**

**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.000.000 (dy milion) Leke.

Pjesëmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqërisë është ne përputhje me kontributin e tij si me poshtë:

1. Ortaku i vetëm themelues **MEMET SALAHI** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlere te përgjithshme 2.000.000 (dy milion) Leke qe përben 100 % te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Kontributi i ortakut themelues është në para dhe do të paguhet prej tij brenda një afati kohor prej 1(një) viti pas regjistrimit në QKB .

Pagesat e kontributit në para do të kryhet pranë një Banke te nivelit te dyte.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt te treteve deri ne vlerën e kontributit te tij te pashlyer ne kapitalin themeltar te shoqërisë;

**Neni 7**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**


Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet ose zvogëlohet me vendim te Ortakut te Vetëm ne përputhje me kërkesat ligjore te parashikuara ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare “, i ndryshuar.

**Neni 8**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

#### Neni 9 **Organi Vendimmarrës**

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetëm, vendos për çështje si :

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;





- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 10 **Administrimi**

Administrator i shoqërisë emërohet ortaku i vetëm **MEMET SALAHI**, i emëruar ne këtë detyre nga momenti i regjistrimit të shoqërisë pranë QKB për një afat kohor 5 vjeçar me të drejte ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë mban të dhënat sa me poshtë

Te dhënat e identifikimit

dhe specimenti i nënshkrimit

**MEMET SALAHI**

(emri dhe mbiemri)

me adrese dhe identitet  
sipas nenit 1 të këtij Statuti



#### Neni 11 **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;


c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;





Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin ose nga rrethanat nuk kishin si mos ta dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12

#### **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;





d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### Neni 13

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni14

#### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetëm vendos rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 15

#### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar me vendim nga ana e



ortakut të vetëm.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë ne kohe ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojnë ne pronësi, ortakut të vetëm të shoqërisë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë vendos nëse dividendi do të shpërndahet apo do të kalojë shoqërisë duke rritur kapitalin e saj.

#### Neni 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; i ndryshuar Ligji për regjistrimin e biznesit.
- d) me vendim të gjykatës;

Ne këtë rast Ortaku i Vetëm merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".


Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

Nëse Ortaku i Vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.





Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimit sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

#### Neni 19

### **Të drejtat e detyrimit e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

#### Neni 20

### **Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar me Ligji për regjistrimin e biznesit.

#### Neni 21

### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi - ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar



Neni 22  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 23  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24  
**Dispozita përfundimtare**

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues **MEMET SALAHI** i shoqërisë tregtare "**MEBASA - ADE**" **shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij origjinal.

ORTAKU I VETEM  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"**MEBASA - ADE**"

  
Emër, mbiemër  
(nënshkrimi)